



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:051572  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05440723

**P.nr.36/22**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lulzim Paçarizi me sekretaren juridike Behije Karaçica, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. G., nga fshati V. komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 me par. 5 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP.II.nr.44/22 të datës 08.03.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 08.03.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Kastriot Memaj, të akuzuarit A. G., ndërsa në mungesë të dëmtuarës, me dt.11.03.2024 shpall, ndërsa me dt. 12.03.2024 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: A. G.** nga i ati S. dhe e ëma M. e lindur M., i lindur me datë ... në fshatin V.komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i R. Të Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datën 14.08.2021, në orët e pas ditës në fsh.T., Komuna Malishevë, me qellim që vetes ose personit tjetër t'i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, në mënyrë të kundërligjshme e përvetëson pasurin e luajtshme të personit tjetër, këtu të dëmtuarës A. T., nga fsh.B., Komuna Malishevë, të cilën pasuri e ka gjetur, ashtu që pasi që të dëmtuarës i ishte vjedhur telefoni i tipit S. A., me datën 08.08.2021, i pandehuri e gjen në rrugë telefonin S. A., dhe duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm e merr, dhe në njëjtën ditë e shet në mobil shop „K.” në F. K., në vlerë prej 30 euro, ku me datën 24.08.2021 i njëjti telefon sekuestrohet tek dëshmitari F. Th., dhe i njëjti i kthehet të dëmtuarës A.T., me datën 23.09.2021.

- Me këtë, ka kryer veprën penale Shpërdorim i pasurisë së huaj, nga neni 318, par.5 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 69, nenit 318 par.5 të KPRK-së, (Kodit nr. 06/L-074) si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtin e:

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në lartësi prej **200 € (dyqind)** euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Si dhe me **dënimin me burgim**, në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 44 lidhur me nenin 43 të KPRK-së, dënimin me burgim prej 3 (tre) muajve, i zëvendësohet dënimi me gjobë në shumën prej **500 € (pesëqind)** euro, të cilën shumë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074) gjykata të akuzuarin e gjykon me **DËNIM UNIK**:

**DËNIMIN ME GJOBË** në lartësi prej **700 € (shtatëqind)** euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguajë në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi., në të kundërtën dënimi i shqiptuar do të zëvendësohet me burg në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh duke llogaritur një ditë burgu 20 euro.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor që të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro), dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € ( njëzet euro) të gjitha këto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

E dëmtuara A. T. nga fsh. B., lidhur me dëmin e shkaktuar udhëzohet në kontestin civil.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.44/22 të dt. 008.03.2022, e ka akuzuar të akuzuarin A. G., për shkak të veprës penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 08.03.2024, sipas urdhër arrestit të lëshuar të dt.08.11.2023, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Kastriot Memaj, i akuzuari A. G., ndërsa nuk ka prezantuar e dëmtuara A. T., ku sipas familjarëve të kontaktuar ne telefon e njëjta është jashtë Kosovës, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari A. G., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilat akuzohet, duke shtuar: të njëjtën e pranoj në mënyrë vullnetare, e di që kam bërë gabim për të cilin jam penduar, i premtoj gjykatës që ne të ardhmen nuk do te kryejë vepre tjetër penale, kërkojë nga gjykata që të më dënoj sa më pakë, në qoftë se gjykata më dënon me burg të njëjtin kërkojë që të zëvendësohet me dënim me gjobë.

Prokurori i shtetit Kastriot Memaj, ka deklaruar: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit gjatë këtij shqyrtimi fillestar pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë ne mënyrë vullnetare prandaj gjykatë i propozoj që të bëj pranimin e fajësisë si shprehje të lirë të vullnetit, dhe të akuzuarin ti shqipton një dënim meritator konform ligjit, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësues dhe rëndues, ne pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe njëherit të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

## 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari A. G. ka kryer veprën penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Raporti i policit H. K. me nr.ID # ... i dt.24.08.2021;
- Deklarata e të dëmtuarës A. T. e dhenë në Stacionin Policor në Malishevë, me datata.20.06.2021 dhe 24.08.2021;
- Deklarata e dëshmitares V. T. e dhenë në Stacionin Policor në Malishevë me dt.24.08.2021;
- Deklarata e dëshmitarit B. T. e dhenë në Stacionin Policor në Malishevë me dt.24.08.2021;
- Deklarata e dëshmitarit F. Th. e dhenë në Stacionin Policor në Malishevë me dt.24.08.2021;
- Deklarata e dëshmitarit K. M. e dhenë në Stacionin Policor në Malishevë me dt.24.08.2021;

- Deklarata e të pandehurit A. G. e dhenë në Stacionin Policor në Malishevë em dt.24.08.2021;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e telefonit të dt.08.08.2021;
- Vërtetimi i kthimit të telefonit të sekuestruar të dt.08.08.2021;
- Dy fotografi të telefonit si dhe shkresat tjera në lëndë.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 318 par.1 të KPRK, është përcaktuar se: „ *Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme përveç të pasurisë së ligjshme të personit tjetër, të cilën ai e ka gjetur ose tek posedimi i së cilës ka arritur rastësisht, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.*

#### 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin A. G., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5, të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, është mbajtës i familjes me punë në sektorin privat në ndërtimtari, andaj gjykata duke mos gjetur rrethana rënduese të akuzuarit i shqiptoj dënimin unik me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449, par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39, parg.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.36/22, me dt.11.03.2024.**

**Sekretarja juridike**  
Behije Karaçica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.